

VENDIM
Nr. 564, datë 29.7.2016

**PËR NGARKIMIN E MINISTRISË SË TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS,
SI ORGAN QENDROR BLERËS, PËR KRYERJEN E PROCEDURËS SË
PROKURIMIT PUBLIK PËR LLOGARI TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 11, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të pikës 2, të nenit 2, të tekstit “Rregullat e prokurimit publik”, bashkëlidhur vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për hartimin e rregullave të prokurimit publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngarkimin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, si organ qendror blerës, për kryerjen e procedurës së prokurimit publik, për llogari të Autoritetit të Aviacionit Civil, për projektin “Realizimi i studimit të fizibilitetit për ndërtimin e një aeroporti në jug të vendit”.

2. Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës të prokurojë fondin limit prej 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekësh, si shumë e miratuar në programin ekonomik të vitit 2016 të Autoritetit të Aviacionit Civil dhe Albcontrol sh.a.

3. Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, me cilësinë e organit qendror blerës, ka përgjegjësi:

a) të bashkërendojë punën me Autoritetin e Aviacionit Civil për zhvillimin e procedurës së prokurimit në emër dhe për llogari të këtij Autoriteti, sipas standardeve ligjore në fuqi, dhe miratimin e specifikimeve teknike, në bashkëpunim me Autoritetin e Aviacionit Civil.

b) të bashkërendojë punën për testimin e tregut, para publikimit të tenderit;

c) të shqyrtojë ankesat e operatorëve ekono-mikë, deri në shpalljen e njoftimit të fituesit.

4. Kontrata me operatorin ekonomik, të shpallur fitues nga kjo procedurë prokurimi, të lidhet nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

5. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe Autoriteti i Aviacionit Civil për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama